



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	07-03-2022	2	viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTK	1221/2022		1/5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.67/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Clirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.67/2022 të datës 26.01.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.03/55 të datës 21.01.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.67/2022 e datës 26.01.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.03/55 i datës 21.01.2022 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat më datë 26.01.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 363/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.03/55 të datës 21.01.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuar është nxjerrë më shkelje ligjore dhe procedurale.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 363/2022 të datës 26.01.2022 të parashtruar nga ankuesi Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vendimin Nr.03/55 ta datës 21.01.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Ankesën me numër protokolli 5329/2021*



të datës 08.11.2021, Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 19.11.2021; Autorizimin për përfaqësim të datës 21.10.2021; Vendimin Nr.16/35 të datës 09.03.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Kërkesën për transferimin e ankuesit me numër protokollit 01/1395 të datës 16.09.2020 të Ministrit të MEA; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 541 të datës 16.09.2020; Propozim Vendimin e datës 06.01.201 pa të dhëna dhe nënshkrim; Vendimin Nr.12/33 të datës 28.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr. 34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesën për rikthim të ligjshmërisë të datës 19.10.2021; Kërkesën për vazhdimin e mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm të MEA-së të datës 08.01.2021; e-mailin e datës 28.10.2021 të F.K për T.M. nga fq 1/5; Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me numër protokollit 193 të datës 11.03.2019; Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me numër protokollit 1057/1 të datës 02.06.2020; Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me nr.prot:1057/2 të datës 29.09.2020; Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me numër protokollit 329 të datës 29.06.2020; Formularin me komente të Ministrit për Vlerësimin e Performances vjetore të Rezultateve në punë të Zyrtarit të Lartë Drejtues me numër protokollit 1057 të datës 25.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për kategorinë e lartë drejtuese i F.Q. i datës 06.01.2021; Procedimi Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.03/55 të datës 21.01.202 i protokolluar në KPMSHCK me numër 304/2022 më datë 24.01.2022; Vendimin Nr.03/55 i datës 21.01.2022 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.908/2021 i datës 05.01.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 5873/2021 të datës 08.12.2021; Propozim pikë për rend të ditës i datës 12.02.2018; Deklaratën e pajtueshmërisë me Rregulloren e punës së Qeverisë Nr.09/2011 e datës 12.02.2018; kërkesën me numër protokollit 1203/2022 të datës 07.03.2022 ;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizua shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi me Vendimin Nr.16/35 të datës 09.03.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ishte emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me mandat tre (3) vjeçar. I njëjti me Vendimin Nr.12/33 të datës 28.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal është transferuar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, për periudhën kohore brenda mandatit të përcaktuar me Vendimin Nr.16/35 të datës 26.03.2018.

Bazuar në kërkesën e Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të datës 06.01.2021, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 42 dhe 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka nxjerrë Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021 për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit për katër (4) vite tjera, duke filluar nga data 10.03.2021.



Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të mbajtur me datë 13.10.2021, ka nxjerrë Vendimin Nr.34/39 të datës 13.10.2021 më të cilin ka shfuqizuar Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021 sipas të cilit ankuesit i ishte vazhduar mandati i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, me ç'rast të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës respektivisht mandati i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Kundër Vendimit Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi fillimisht me datë 19.10.2021, ka parashtruar kërkesë për rikthim të ligjshmërisë pranë Ministres së Ministrisë për Ekonomi. Pas heshtjes se kësaj të fundit, ankuesi me datë 08.11.2021, paraqet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil, i cili me Vendimin A.nr.908/2021 të datës 05.01.2022 ka anuluar Vendimin Nr.34/39 të datës 13.10.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.

Duke vepruar sipas Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil A.nr.908/2021 të datës 05.01.2022, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të datës 21.01.2022, ka nxjerrë Vendimin Nr.03/55 duke shfuqizuar Vendimin Nr.13/59 të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Kosovës.

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi pretendon se Vendimi Nr.03/55 i datës 21.01.2022, i Qeverisë së Kosovës është nxjerrë me shkelje ligjore dhe procedurale. Me tej thekson se emërimi i ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ka qenë në pajtueshmëri më të gjitha procedurat ligjore të cilat kanë qenë të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbim Civil, si dhe ri zgjatja e mandatit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Ekonomi dhe Ambient është bërë në pajtim me nenin 42 paragrafi 5 dhe nenin 83 paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta anuloj Vendimin Nr.03/5 të datës 21.01.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe të lë në fuqi Vendimin nr.13/59 të datës 21.01.2020 për vazhdimin e mandatit të ankuesit Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Ekonomi dhe Ambient, si dhe të detyroj këtë të fundit që ankuesit ti kompensoj të gjitha pagat dhe beneficionet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, në mënyrë retroaktive nga data 13.10.2021 deri në kthimin e ankuesit në punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se emërimi i ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal është bërë sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil duke qenë në fuqi në këtë kohë, kurse transferimi i përkohshëm dhe ri zgjatja e mandatit është bërë në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i zbatueshëm në kohën e nxjerrjes së Vendimit Nr.12/33 të datës 28.09.2020 dhe Vendimit Nr.13/59 të datës 21.01.2021. Ndërlidhur me këtë konstatim, Kolegji sjell në vëmendje faktin se fillimisht Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka hyrë në fuqi me datë 10.09.2019, i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës nga data 25.11.2019 deri me 30.06.2020 përmes Vendimit Nr.ref.VMP 1472/19 të datës 25.11.2019 për vendosjen e masës së përkohshme si dhe Vendimit për vazhdimin e masës së përkohshme Nr.ref.VVMP 1555/20 të datës 27.04.2020. Me tej, me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i njëjti është i zbatueshëm nga data 10.07.2020 në raport me të gjitha institucionet tjera përjashtimisht institucioneve si në pikën tre të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankesë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht



nenit 52 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës. 2. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 2.3. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil, ....6. Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme..* si dhe nenit 83 paragrafi 8 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se : *Për një nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), i cili është duke shërbyer në mandatin e tij/saj të parë, do të aplikohet neni 42, paragrafi 2 i këtij ligji.*

Ndërlidhur me këtë të fundit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK)-Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, konkretisht nenin 26 ku theksohet se: *Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar për herë të parë sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), ka të drejtë në ri zgjatje edhe vetëm njëherë të mandatit të tij prej katër (4) viteve.* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji vlerëson se Vendimi Nr.13/59 i datës 21.01.2021 i Qeverisë së Kosovës për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore si me lart, sepse, ankuesi me Vendimin Nr.12/33 të datës 28.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ishte transferuar përkohësisht nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në Ministrinë për Ekonomi dhe Ambient, kështu që i njëjti me kalimin e afatit të përcaktuar me vendimin për transferim, duhej të kthehej në ministrinë përkatëse nga është bërë transferimi ashtu siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, gjegjësisht në rastin konkret zgjatja e mandatit të ankuesit i emëruar sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, mund të behej vetëm në pozitën ku ishte emëruar sipas Vendimit Nr.16/35 të datës 09.03.2018 të Qeverisë së Kosovës dhe se kërkesën për vazhdim të mandatit të ankuesit mund ta bënte vetëm Ministri i Zhvillimit Rajonal e jo Ministri për Ekonomi dhe Ambient.

Nisur nga konstatimi si me lartë, e në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se një akt administrativ i nxjerrë si rezultat i shkëljes të dispozitave procedurale dhe materiale, konsiderohet akt i paligjshëm, e mbi këto arsye rrjedhë se Qeveria e Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.03/55 i datës 21.01.2022 ka vepruar në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që me të drejtë Kolegji vlerëson se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Në pikëpamje të nenit 53 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nisur nga fakti se ankuesi ka përfunduar mandatin e parë duke qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, Kolegji vlerëson se në raportin juridik-administrativ i krijuar si pasojë e shfuqizimit të vendimit për ri zgjatje të mandati të ankuesit duhet të merren në konsideratë aplikimi i dispozitave të nenit 83 paragrafi 8 ndërlidhur me neni 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit.Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë me të cilat shprehimisht është paraparë se: *7. Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimin detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale. 8. Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë*



drejtues për një periudhë 3 mujore. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional, të caktuar nga Njësia e pranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil.

Andaj, duke përmbledhur sa më sipër, Kolegji për Vendosjen dhe Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimit.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.67/2022

Çlirim Zeka

*Zeka*  
Procesmbajtës



Ardita Haxhnikaj-Demi

*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit avokat
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë për Ekonomi;
- Ministrit për Zhvillim Rajonal; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

